



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISË SKRAPAR

VENDIM

Nr.18, datë 29.04.2025

“PËR DHËNIEN E NDIHMËS FINANCIARE PËR FATKEQËSINË E RËNIES SË ZJARRIT NË DATËN 02.11.2024 NË BANESËN E Z.TAULLA ZAIMI, LAGJJA “2 DHJETORI” ÇOROVODË NJËSIA ADMINISTRATIVE ÇOROVODË, BASHKIA SKRAPAR”.

Këshilli Bashkiak Skrapar në mbledhjen e datës 29.04.2025, mori në shyrtrim projektaktin e hartuar Grupi i Menaxhimit Strategjik, në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për vetqeverisjen vendore” i ndryshuar, ligjit nr.45/2019 “Për Mbrojtjen Civile”, VKM nr.329 datë 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”, si dhe vendimit të Këshillit Bashkiak nr.86.datë 21.12.2022 “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2023-2025 dhe buxhetin e vitit 2025, të Bashkisë Skrapar dhe institucioneve në varësi të saj:

VENDOSI:

1-Të akordojë ndihmën financiare prej 268.925 (dyqind e gjashtëdhjetë e tetë mijë e nëntëqindë e njëzet e pesë) lekë, familjes së z.Taulla Zaimi për dëmet e shkaktuara nga zjarri i rënë në lagjen “2 Dhjetori” Çorovodë, Njësia Administrative Çorovodë, Bashkia Skrapar.

2-Efekte financiare do të përballohen nga fondi i Emergjencave Civile, parashikuar në buxhetin e vitit 2025 të Bashkisë Skrapar.

Vendimi u miratua me 10 Vota pro, vota kundër - s’ka, abstenim – s’ka

Për konfirmim Prefektit të Qarkut Berat.



KRYETARE E KËSHILLIT BASHKIAK

Elsa PETRITAJ

